

NDIKIM I ZGJEDHJEVE LOKALE 2021 NË PUNËN E KUVENDIT TË KOSOVËS

Analizë e shkurtër

DHJETOR, 2021

The background of the cover features a stylized illustration in shades of red and orange. It depicts a crowd of people in silhouette, holding up flags and banners. In the foreground on the right, there is a large silhouette of a man, likely a political figure, pointing upwards. The background shows several multi-story buildings with windows, suggesting an urban or institutional setting. The sky is filled with soft, rounded shapes representing clouds.



Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e zhvillimit
të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës
kundër korrupsion përmes promovimit të
transparencës, llogaridhënies dhe integritetit
në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autore: Agnesa Haxhiu

Dizajni: Envinion

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
DEPUTETËT – GARUES NË ZGJEDHJET LOKALE 2021 DHE POZITAT (FUNKSIONET) E TYRE NË KUVEND	7
SA E NDIKOJNË LËVIZJET E DEPUTETËVE CILËSINË E PËRFAQËSIMIT TË KUVENDIT?	10
NDIKIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE NË PERFORMANCËN E KUVENDIT	12
KRYESIA E KUVENDIT	12
SEANCA PLENARE	12
AGJENDA LEGJISLATIVE	12
MBIKËQYRJA PARLAMENTARE	13
PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË SEANCA PLENARE.....	13
KOMISIONET PARLAMENTARE	13
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	14



HYRJE

Më 15 qershor 2021, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 17 tetorin 2021 si datë për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në Kosovë. Bazuar në datën e zgjedhjeve të përcaktuar nga Presidentja, KQZ-ja caktoi datën e nisjes së fushatës zgjedhore më 16 shtator. Qysh nga shpallja e datës së zgjedhjeve, tre muaj para se të niste zyrtarisht fushata, partitë politike kishin filluar t'i bënin publik emrat e disa prej kandidatëve të tyre për kryetar komune, dhe një pjesë e tyre kishin filluar para - fushatën.

Kuvendi i Kosovës, gjatë sesionit pranveror parlamentar mars – gusht 2021, gjegjësisht sesioni i parë i punës së legjislaturës së VIII-të, ishte karakterizuar me një ritëm të ngadaltë të punës në aspektin ligjvënës por me performancë më të mirë në rolin mbikëqyrës. Ndonëse kjo legjislaturë ka një shumicë të konsoliduar, mungesa e kuorumit ka vazhduar të jetë pengesë në punën e Kuvendit. Mungesat e shumta të deputetëve në seancë, padyshim, kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punimeve plenare. Dinamika e ultë e punës e ka përcjellur Kuvendin edhe në dy muajt e parë të sesionit vjeshtor që korrespondon me periudhën sa kanë zgjatur zgjedhjet lokale 2021. Numër i vogël i seancave të zhvilluara, i mbledhjeve të komisioneve, e për rrjedhojë edhe numër shumë i vogël i ligjeve të miratuara, është bilanci i punës së Kuvendit përgjatë kësaj periudhe kohore.

Fokusi i madh i partive politike parlamentare në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit dhe balotazhit të 14 nëntorit, ka bërë që të anashkalohet pothuajse plotësisht puna në Kuvend. Ndonëse procesi i zgjedhjeve lokale nuk do të duhej të ndikonte në punët e institucioneve të nivelit qendror, në Kosovë tradicionalisht është vërejtur jo vetëm angazhim dhe prezencë e deputetëve nëpër tubime zgjedhore të partive përkatëse, por edhe pjesëmarrje direkte si kandidatë në garën zgjedhore lokale – fenomen ky që edhe në këto zgjedhje ka qenë mjaft evident. Rreth 15% e përbërjes së kësaj legjislature të Kuvendit kanë qenë kandidatë për kryetar të komunave, duke përfshirë këtu edhe ata deputetë që ishin pjesë edhe e listave për anëtarë të Kuvendeve Komunale. Një pjesë e deputetëve të tjerë kanë pasur role të caktuara edhe në shtabet zgjedhore të partive të tyre politike. Një gjendje e tillë duket se iu ishte përshtatur të gjitha partive politike parlamentare, an-



Fokusi i madh i partive politike parlamentare në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit dhe balotazhit të 14 nëntorit, ka bërë që të anashkalohet pothuajse plotësisht puna në Kuvend. **Rreth 15% e përbërjes së kësaj legjislature të Kuvendit kanë qenë kandidatë për kryetar të komunave, duke përfshirë këtu edhe ata deputetë që ishin pjesë edhe e listave për anëtarë të Kuvendeve Komunale.**

-daj edhe neglizhenca ndaj punës në Kuvend ishte në dukje të parë e koordinuar. Në paaftësi për të balancuar angazhimet e tyre në fushatë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në Kuvend, deputetët e kanë ndikuar drejtpërdrejt funksionimin e mirëfilltë të Kuvendit, probleme këto që janë vërejtur më së shumti tek mbledhjet e Kryesisë dhe mbajtjes së seancave. Si pasojë, ka pasur ngecje edhe sa i përket përmbushjes së agjendës legjislative.

Qëllimi i kësaj analize të shkurtër është që të nxjerrë në pah ndikimin që zgjedhjet lokale 2021 kanë pasur në punën dhe performancën e Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht në punimet e të gjitha trupave të Kuvendit për periudhën kohore 16 shtator – 14 nëntor 2021¹. Analiza trajton fenomenin e kandidimit të deputetëve për pozita tjera publike apo marrjen e posteve të tjera publike si dhe ndikimin që këto lëvizje sjellin në punën e Kuvendit dhe në cilësinë e përfaqësimit të Kuvendit. Njëkohësisht, ky punim analizon performancën e deputetëve gjatë kësaj periudhe në rolin ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues, me theks të veçantë ngecjet dhe vështirësitë që janë hasur gjatë kësaj kohe.

¹ Kjo periudhë korrespondon me fillimin zyrtar të periudhës së fushatës zgjedhore, deri në mbajtjen e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë komunash.





DEPUTETËT – GARUES NË ZGJEDHJET LOKALE 2021 DHE POZITAT (FUNKSIONET) E TYRE NË KUVEND

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale nuk ua ndalon personave që mbajnë post publik, qoftë të zgjedhur apo të emëruar, të garojnë për një post tjetër publik. Megjithatë, sipas ligjeve të lartpërmendura, nuk lejohet mbajtja e dy posteve njëkohësisht. Në Ligjin për Zgjedhjet Lokale, përkatësisht në nenin 9.3, thuhet se *‘Kandidati i subjektit të certifikuar politik për pozitë të Kryetarit të Komunës mund të certifikohet si kandidat në zgjedhje tjera siç janë ato për Kuvend të Kosovës apo Kuvend të Komunës, por do të mbajë vetëm një pozitë të zgjedhur. Nëse zgjidhet si Kryetar Komune, kandidati nuk do të ketë të drejtë të mbajë vendin në Kuvendin e Kosovës apo Kuvendin e Komunës’.*

Ligji për Zgjedhjet Lokale përcakton gjithashtu që ndonëse ligjërisht është e lejuar që një person që mban post publik të bëhet pjesë e një gare zgjedhore, ai personi i cili mban post publik, të zgjedhur ose emëruar, nuk mund ta përdorë atë post apo ndonjë nga burimet e tij për qëllim të sigurimit të votave.²

Garës për të parin e komunës, në zgjedhjet lokale 2021, i kanë hyrë 13 deputetë të Kuvendit të Kosovës, ku tre prej tyre kanë qenë edhe bartës të listave të tyre përkatëse kurse si bartës të listave për assemble komunale kanë garuar edhe pesë deputetë të tjerë. Nëse e shohim në përqindje, i bie që 15% e përbërjes së plotë të kësaj legjislatore kanë qenë pjesë e garës zgjedhore lokale 2021. Grupi parlamentar me më së shumti deputetë që kanë garuar për pozitën e kryetarit të komunës është Lëvizja Vetëvendosje, me gjithsej gjashtë të tillë. Grupi i dytë me më së shumti të kandiduar për kryetar komune është ai i PDK-së me katër deputetë, i



Kandidati i subjektit të certifikuar politik për pozitë të Kryetarit të Komunës mund të certifikohet si kandidat në zgjedhje tjera siç janë ato për Kuvend të Kosovës apo Kuvend të Komunës, por do të mbajë vetëm një pozitë të zgjedhur. **Nëse zgjidhet si Kryetar Komune, kandidati nuk do të ketë të drejtë të mbajë vendin në Kuvendin e Kosovës apo Kuvendin e Komunës**

pasuar nga grupi parlamentar i AAK-së me dy deputetë të kandiduar. Ndërsa grupi parlamentar me më së paku deputetë që kanë garuar në këto zgjedhje ka qenë ai i LDK-së me vetëm një të tillë. Kurse, nga grupet parlamentare të komuniteteve nuk ka pasur kandidatura të tilla.

Ndërkaq sa i përket deputetëve që kanë garuar si bartës të listave për kuvend komunal, nga grupi parlamentar i PDK-së, LS-së dhe ai Multietnik kanë garuar nga dy deputetë, të pasuar nga dy grupet e tjera parlamentare si LVV-ja dhe AAK-ja me nga një deputet.

² Neni 3, paragrafi 4 i ligjit.





Deputeti/ja	Grupi parlamentar	Funksioni/roli në Kuvendin e Kosovës	Kandidatura
 Mimoza Kusari - Lila	LVV	Kryetare e grupit parlamentar të LVV-së	Kandidate për kryetare të Gjakovës
 Adnan Rrustemi	LVV	Kryetar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së	Kandidat për kryetar të Lipjanit
 Alban Hyseni	LVV	Anëtar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së	Kandidat për kryetar të Gjilanit
 Visar Korenica	LVV	Anëtar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere	Kandidat për kryetar të Rahovecit
 Salih Zyba	LVV	Nënkryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së; dhe anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë	Kandidat për kryetar të Suharekës
 Valon Ramadani	LVV	Anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media	Kandidat për kryetar të Ferizaj/ bartës i listës
 Bedri Hamza	PDK	Anëtar i Kryesisë së Kuvendit	Kandidat për kryetar të Mitrovicës
 Urani Ismaili	PDK	Anëtar i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Kandidat për kryetar të Prishtinës
 Fadil Nura	PDK	Anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë; dhe anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike	Kandidat për kryetar të Skenderajt
 Floretë Zejnullahu	PDK	Anëtare e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media	Kandidate për kryetare të Podujevës/ bartëse e listës për asamble komunale
 Eliza Hoxha	PDK	Anëtare e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport	Kandidate për asamble të komunale të Prishtinës /bartëse e listës
 Besnik Tahiri	AAK	Kryetar i grupit parlamentar të AAK-së	Kandidat për kryetar të Podujevës





Deputeti/ja	Grupi parlamentar	Funksioni/roli në Kuvendin e Kosovës	Kandidatura
 Bekë Berisha	AAK	Kryetar i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Kandidat për kryetar të Istogut/ bartës i listës për asamble komunale
 Anton Çuni	LDK	Anëtar i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Kandidat për kryetar të Prizrenit
 Fridon Lala	Multietnik / IRDK	Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Komisionit për Integrim Evropian dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së	Kandidat për asamb-lenë komunale të Gjakovës /bartës i listës
 Bahrim Šabani	Multietnik / VAKAT	Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë	Kandidat për asamb-lenë komunale të Prizrenit /bartës i listës
 Adem Hodža	LS / JGP	Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike	Kandidat për asamb-lenë komunale të Dragashit /bartës i listës
 Ivan Todosijević	LS	Anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	Kandidat për asamb-lenë komunale të Zveçanit /bartës i listës

Fig 1. Të dhënat për deputetët dhe tashmë ish-deputetët që kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale të ndarë sipas grupit parlamentar, funksionit në Kuvend dhe kandidaturës në zgjedhjet lokale 2021.

Gjashtë nga këta deputetë – kandidatë për kryetar komune janë deputetë që kanë pasur edhe funksione udhëheqëse brenda trupave të punës së Kuvendit. Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që kanë kryetarët e grupeve parlamentare në punën e Kuvendit dhe mbarëvajtjen e punimeve plenare, mos prezenca e tyre e rregullt në Kuvend ka ndikuar drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e përgjithshme të punimeve të Kuvendit. Po ashtu, duke qenë se edhe kryetarët e komisioneve parlamentare kanë kompetencë për thirrjen e mbledhjeve të komisioneve, të kryesimit dhe caktimin e agjendës së atyre takimeve, mungesa e angazhimit të tyre në kryerjen e këtyre detyrave ka ndikuar në dinamikën e punës së komisioneve përkatëse.

Nga radhët e grupit parlamentar të PDK-së, kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Bedri Hamza, ishte edhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës. Në anën tjetër,

kryetarët e grupeve parlamentare të LVV-së dhe AAK-së, Mimoza Kusari-Lila dhe Besnik Tahiri, ishin njëkohësisht kandidatë për kryetarë të komunave respektive. Ndërsa, si kandidatë për kryetarë komunash ishin nga një deputet i po këtyre dy grupeve parlamentare, të cilët mbajnë pozitën e kryetarëve të komisioneve parlamentare – atij për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së (Adnan Rustemi) dhe Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes (Bekë Berisha). Gjithashtu, Salih Zyba, deputet i GP të LVV-së dhe nënkryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së, ishte po ashtu kandidat për kryetar komune. Kurse, deputetët e tjerë që po ashtu kanë qenë pjesë e garës zgjedhore lokale kanë qenë anëtarë të një apo më shumë komisioneve parlamentare përkatëse.





SA E NDIKOJNË LËVIZJET E DEPUTETËVE CILËSINË E PËRFAQËSIMIT TË KUVENDIT?

Në Kosovë, politikanët në vazhdimësi e kanë parë pozitën e deputetit si mundësi promovimi për pozita tjera publike. Ndonëse, të qenit deputet në një republikë parlamentare, si në rastin e Kosovës, paraqet pozitën më të lartë të përfaqësimit në organin përfaqësues dhe ligjvënës.

Pavarësisht rëndësisë, përgjegjësisë dhe privilegjit për të qenë përfaqësues i popullit në organin më të lartë ligjvënës, në secilën legjislaturë të Kuvendit ka pasur deputetë që kanë lënë mandatin e tyre për të marrë pozita tjera ekzekutive në nivel qendror apo atë lokal. Kjo, edhe pse qytetarët u kanë dhënë votën për t'i përfaqësuar ata dhe interesat e tyre në Kuvend.

Grupet parlamentar që kanë shumicën parlamentare dhe rrjedhimisht udhëheqin me qeverinë gjithmonë janë me të prekurat nga ikjet e shumë figurave të rëndësishme që janë vlerë për atë grup të caktuar parlamentar. Me formimin e qeverisë, rëndom figurat kyçe të partisë, që veçse kanë fituar ulëse në Kuvend, marrin pozita udhëheqëse në ekzekutiv për t'iu lënë vendin kandidatëve për deputetë që janë në radhë në listë për nga numri i votave. Por, në rastin e zgjedhjeve lokale, pothuajse të gjitha grupet parlamentare ndikohen nga lëvizjet e shumë prej figurave të rëndësishme të grupeve të tyre, marrë parasysh edhe rëndësinë që i kushtojnë partitë politike zgjedhjeve lokale.

Në pothuajse secilën palë zgjedhje lokale përsëritet e njëjta situatë, ku një numër i caktuar i deputetëve i futen garës për kryetar komune, nga të gjitha grupet parlamentare. Në zgjedhjet lokale të vitit 2017 ku në garë për kryetare komune ishin 13 deputetë të Kuvendit të Kosovës, vetëm dy kishin fituar zgjedhjet në komunat përkatëse dhe të dy i përkisnin Lëvizjes Vetëvendosje. Ndërsa, në këto palë zgjedhje, nga 13 deputetë që ishin bërë pjesë e garës për të parin e komunës, tre kanë arritur që të fitojnë këtë garë zgjedhore, prej të

cilëve dy nga grupi parlamentar i PDK-së dhe një nga grupi parlamentar i LVV-së. Grupi parlamentar i PDK-së doli më "i prekuri" pasi që nga kjo garë 'humbi' tre deputetë – figura këto të rëndësishme të partisë. Nga PDK-ja përveç dy tashmë ish-deputetëve Bedri Hamza dhe Fadil Nura që kanë fituar garën për kryetar komune, ish-deputeti Uran Ismaili si kandidat për kryetar të Komunës së Prishtinës, kishte dhënë dorëheqje që në fillim në fushatën zgjedhore, ndonëse i njëjti nuk e ka fituar garën. Uran Ismaili ishte deputeti i vetëm që kishte dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit për tu fokusuar në garën e tij zgjedhore në nivel lokal. Ndërsa nga LVV-ja, i vetmi fitues nga grupi i deputetëve që iu ishin futur garës për të parin e komunës ishte ish-deputeti Alban Hyseni.

Përveç dallimit në funksionet dhe rëndësinë që mund të kenë këta tashmë ish-deputetë në partitë e tyre respektive për dallim prej atyre deputetëve që i kanë zëvendësuar ata, ka edhe një dallim të madh në mbështetjen popullore që kanë marrë në zgjedhjet e fundit parlamentare të 14 shkurtit.

Ish-deputeti Uran Ismaili, që kishte dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit, paraprakisht si pjesë e PDK-së ka qenë shef i stafit të ish-Kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, më pastaj ministër i shëndetësisë në Qeverinë "Haradinaj", si dhe ka qenë deputet në dy legjislaturat e fundit. Në zgjedhjet e fundit të parakohshme parlamentare kishte arritur të marrë 26,716 vota, duke qenë kandidati i dytë më i votuar i listës së PDK-së. Pas dorëheqjes, ai u zëvendësua nga Hisen Berisha, ish-komandant të UÇK-së në Brigadën 138 "Agim Ramadani", i cili ishte anëtarësuar para më shumë se dy vitesh në PDK, ndërsa në zgjedhjet e fundit parlamentare kishte siguruar 9,168 vota, apo rreth 18 mijë vota më pak sesa ish-deputeti Uran Ismaili.






Fig2. Votat e ish-deputetëve që kanë dhënë dorëheqje nga mandati i deputetit dhe deputetëve zëvendësues të tyre.

Pjesë e garës zgjedhore lokale nga PDK-ja ishte edhe tashmë ish-deputeti Bedri Hamza, i cili ishte deputet në dy mandate, ndërsa në zgjedhjet e fundit parlamentare ishte renditur si deputeti i tretë më i votuar në listën e PDK-së me gjithsej 23,976 vota. Ai kishte shërbyer si guvernator në BQK, dhe si pjesë e PDK- së ishte ministër i financave. Pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, ai u zëvendësua nga deputeti Rashit Qalaj, i cili ishte anëtarësuar në PDK para një viti, në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, në të cilat kishte marrë 9,160 vota, apo rreth 15 mijë vota më pak se ish-deputeti Hamza. Rashit Qalaj paraprakisht ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Policisë së Kosovës.

Ish-deputeti Fadil Nura, ndonëse deputet për herë të parë këtë legjislaturë, ai më parë kishte pasur pozita të larta udhëheqëse si pjesë e PDK-së. Fadil Nura ka qenë nënkryetar i komunës së Skenderajt për një mandat, më pastaj U.D i kryetarit të komunës së Skenderajt për një mandat, si dhe zëvendësministër i drejtësisë në Qeverinë "Haradinaj". Në zgjedhjet e fundit ai kishte arritur të grumbullojë 9,270

vota, duke qenë në mesin e top tre deputetëve më të votuar të PDK-së në Skenderaj. Ish-deputeti Nura, pas fitores në Skenderaj dhe dorëheqjes nga mandati i deputetit është zëvendësuar nga Isak Shabani, i cili ka fituar në zgjedhjet e fundit 8,729 vota, që është numër i përafërt i votave me ato të ish-deputetit Fadil Nura.

Nga zgjedhjet lokale, edhe grupi parlamentar i VV-së ka 'humbur' një deputet si rezultat i fitores së tashmë ish-deputetit Alban Hyseni në Komunën e Gjilanit. Ai ishte deputet dy mandate, ndërsa në zgjedhjet e fundit parlamentare kishte dalë deputeti më i votuar nga lista e LVV-së në Gjilan, me plot 15,200 vota. Në vend të tij, tashmë mandatin e deputetit e ka fituar Halil Thaçi, i cili ishte njëkohësisht kandidat i LVV-së për kryetar të Komunës së Obiliqit, në zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Aktualisht, ai është udhëheqës i qendrës së LVV-së në Obiliq. Në zgjedhjet e fundit parlamentare ai kishte arritur të siguronte 5,921 vota, apo rreth 9 mijë vota më pak se ish-deputeti Alban Hyseni.





NDIKIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE NË PERFORMANCËN E KUVENDIT

Kuvendi, pas fillimit të sesionit vjeshtor është karakterizuar me një dinamikë të ulët të punës, si rezultat i fokusit që kanë pasur partitë politike parlamentare tek zgjedhjet lokale, si dhe pjesëmarrjes së deputetëve në aktivitete zgjedhore nëpër komuna. Për periudhën, nga fillimi i sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit (13 shtator e deri në përfundim të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale më datë 15 nëntor), Kuvendi ka mbajtur vetëm tri seanca të reja plenare dhe një vazhdim të seancës.

Kryesia e Kuvendit

Kryesia e Kuvendit, si përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit, dhe caktimin e agjendës së punimeve të Kuvendit, gjatë kësaj periudhe ka hasur në vështirësi për funksionim të mirëfilltë për shkak të pamundësisë së aritjes së kuorumit. Mungesat e paarsyeshme të anëtarëve të Kryesisë në mbledhjet e caktuara, mospjesëmarrja e qëllimshme e Listës Serbe rrjedhimisht anëtarit të tyre në Kryesi, e më vonë dorëheqja e nënkryetarit Hamza, ka bërë që Kryesia ta ketë të pamundur arritjen e kuorumit prej katër anëtarëve në mënyrë që t'i mbajë mbledhjet e saj. Për periudhën raportuese, tri mbledhje të Kryesisë kanë dështuar në mungesë të kuorumit, kurse një mbledhje tjetër ishte anuluar pak minuta para se të fillonte, pa dhënë sqarime për arsyen e anulimit të saj.

Seancat plenare

Mos mbajtja e mbledhjeve të Kryesisë, ka pamundësuar edhe caktimin e seancave të reja plenare duke bërë kështu që çështjet që ishin për më shumë se tri javë në pritje për tu shqyrtuar nga deputetët të shtyhen deri në përfundimin

e zgjedhjeve lokale dhe kthimit të vëmendjes së deputetëve në punën në Kuvend. Për shkak të mungesës së kuorumit dhe pamundësisë së funksionimit të rregullt të punës edhe rregulli parlamentar për zhvillimin e punimeve plenare ditën e enjte dhe të premte nuk është respektuar. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi edhe ato pak seanca të mbajtura i ka zhvilluar në fillim të javës, në ditën e hënë dhe të martë.

Meqë Rregullorja e Punës përcakton që minimumi i seancave të mbajtura brenda një muaji është dy, bazuar në numrin e seancave të mbajtura nga Kuvendi për periudhën raportuese ky rregull është përfillur. Mirëpo një rregull i tillë përcakton vetëm minimumin e numrit të seancave që Kuvendi është i obliguar të zhvillojë brenda një muaji por në anën tjetër numrin e seancave në përgjithësi e përcakton agjenda që ka Kuvendi dhe në këtë rast agjenda ka qenë e stërngarkuar me më shumë se 30 pika në pritje për shqyrtim.

Agjenda legjislative

Dinamika e ulët e punës përgjatë kohës sa ka zgjatur procesi zgjedhor më së shumti ka ndikuar në përmbushjen e agjendës legjislative. Nga vetëm shtatë ligje të miratuara deri në përfundim të sesionit pranveror, Kuvendi nga fillimi i sesionit vjeshtor kur edhe kishte filluar fushata zgjedhore e deri në përfundim të balotazhit, kishte miratuar vetëm edhe katër projektligje të tjera. Nga këto katër ligje të miratuara, tri prej tyre janë marrëveshje ndërkombëtare. Kurse në procedurë të shqyrtimit nga përmbyllja e sesionit pranveror kishin mbetur edhe 22 projektligje, numër ky që deri në fund të periudhës raportuese arriti në 57 sosh.



Mbikëqyrja parlamentare

Përveç aspektit ligjvënës, performanca e deputetëve në rolin mbikëqyrës ka qenë shumë e dobët. Ndonëse Rregullorja përcakton që secili deputet ka të drejtën e parashtimit të deri në dy pyetje parlamentare për një seancë, këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar vetëm pesë deputetë në tri seancat e mbajtura. Për periudhën raportuese janë parashtruar vetëm 11 pyetje parlamentare, prej të cilave nga katër pyetje kanë parashtruar GP i AAK-së dhe ai i LVV-së, ndërsa tre të tjera janë parashtruar nga GP i PDK-së.

Në kuadër të mekanizmave për ushtrimin e roli mbikëqyrës, Kuvendi për këtë periudhë kohore nuk ka mbajtur asnjë interpelancë apo debat parlamentar. Ndonëse ka pasur dy iniciativa nga grupi parlamentar i AAK-së, i cili kishte iniciuara kërkesat për dy debate parlamentare, një për çështjen e rritjes së çmimeve dhe një për veprimet e Qeverisë për alternativat e diversifikimit të energjisë dhe veçanërisht Projektin e Gazit me MCC, të dyja kërkesat nuk janë proceduar në seancë për diskutim, për shkak të mungesës së kuorumit në Kryesi dhe pamundësisë për caktimin e seancave për disa javë radhazi.

Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare

Pavarësisht numrit të vogël të seancave të mbajtura, deputetët kanë vazhduar më praktikën e mungesave. Në tri seanca të mbajtura (duke përfshirë në këtë përlllogaritje edhe vazhdimin e seancës që është mbajtur në të njëjtën ditë me njërin nga seancat e reja) janë shënuar 56 mungesa nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, që mesatarisht i bie rreth 19 mungesa për një seancë. Nëse i shohim mungesat sipas grupeve parlamentare, prin GP i LS-së me 32 mungesa, i pasuar nga GP i PDK-së me tetë mungesa, pastaj GP i LVV-së dhe GP Multietnik me nga katër mungesa, GP i LDK-së me tri mungesa, GP i AAK-së me dy mungesa dhe tri mungesa nga deputeti i pavarur Fadil Gashi. Ajo çfarë vërehet nga të dhënat e pjesëmarrjes së deputetëve në seanca është numri jo i lartë i mungesave nga ana e deputetëve që kanë qenë pjesë e garës zgjedhore lokale. Në numrin e përgjithshëm të mungesave, vetëm shtatë mungesa janë shënuar nga deputetët që kanë qenë duke garuar për kryetar komune. Deputetët që kanë munguar janë Antoni Quni, Fadil Nura dhe Bedri Hamza me nga dy mungesa, si dhe Alban Hyseni me një mungesë.

Komisionet parlamentare

Dinamika e punës së komisioneve parlamentare, në rrethana normale është shumë e madhe marrë parasysh fushëveprimtarinë e gjerë dhe volumin e punëve që kanë secila prej tyre përgjatë një vitit kalendarik të punës. Mirëpo, një dinamikë e tillë e punës nuk është vërejtur gjatë periudhës raportuese meqë gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar 65 mbledhje të komisioneve parlamentare.

Katër komisione nga 14 sa janë gjithsej nuk e kanë respektuar kriterin prej së paku dy mbledhjesh brenda muaji, ndërsa Komisioni për Komunitete dhe Kthim nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për periudhën raportuese. Kurse, gjatë muajve tetor dhe nëntor (deri në përfundim të zgjedhjeve) Komisioni për Administratë Publike dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje.

Përveç në seanca dhe mbledhje të Kryesisë, mungesa e kuorumit është vërejtur edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Janë evidentuar tri mbledhje të dështuara si rezultat i mungesës së kuorumit, në pamundësi të arritjes së numrit prej gjashtë deputetëve, për të zhvilluar mbledhjet. Sipas të dhënave të nxjerra nga monitorimi i punës së komisioneve, në mbi 50% të të gjitha mbledhjeve të mbajtura për këtë periudhë kohore, të pranishëm kanë qenë jo më shumë se shtatë nga 11 anëtarë sa janë gjithsej në secilin komision. Kurse, në asnjërin nga 65 mbledhjet e mbajtura nga komisionet, nuk kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët në përbërje të plotë.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ashtu siç edhe pritej, fushata për zgjedhjet lokale të 17 tetorit dhe balotazhit të 14 nëntorit ka ulur dukshëm efikasitetin e punës së legjislativit, për shkak të fokusit që partitë politike parlamentare kanë pasur në këtë proces zgjedhor, ku si garues morën pjesë rreth 15% e përbërjes së kësaj legjislature. Përderisa në shtetet me demokraci të konsoliduar, fenomeni i ndikimit të procesit të zgjedhjeve lokale në punën e institucioneve të nivelit qendror nuk gjen zbatim, në Kosovë është kthyer në praktikë pjesëmarrja direkte e deputetëve si kandidatë në garën zgjedhore lokale, por edhe angazhimi dhe prezenca e deputetëve nëpër tubime zgjedhore të partive përkatëse.

Përveç ndikimit në performancën e institucioneve qendrore, në këtë rast të legjislativit, kandidimi i deputetëve në zgjedhjet lokale, dhe pastaj dorëheqja nga mandati i deputetit për një post ekzekutiv në nivel lokal e dobëson edhe përfaqësimin në Kuvend. Në shumë raste, deputetët që heqin dorë nga mandati i deputetit për të marrë post në nivel lokal janë edhe figura shumë të rëndësishme të partive përkatëse por edhe deputet me mbështetje të madhe popullore. Të njëjtit, në shumicën e rasteve zëvendësohen nga deputetë me të cilët kanë dallim të madh në përkrahjen popullore të shprehur përmes votës në zgjedhjet parlamentare gjë e cila shtrou diskutimin nëse në këto raste ndodhë edhe deformimi i vullnetit qytetar. Siç e thonë shumë studiues të shkencave politike, mënyra e funksionimit dhe organizimit të brendshëm të partive politike është parakusht për të pasur qeverisje demokratike dhe zhvillimit të shtetit në përgjithësi. Në kuadër të procesit të demokratizimit të brendshëm të partive politike në Kosovë, është më se e nevojshme që të rishikohet edhe mënyra se si përzgjidhen kandidatët për zgjedhje në të dyja nivelet. Nominimi i kandidatëve në listat zgjedhore të partive politike, si për nivelin qendror ashtu edhe atë lokal do të duhej të adresohet përmes rregullave ligjore. Duke e përcaktuar paraprakisht formën se si përpilohet lista e kandidatëve në një garë zgjedhore, në njërën anë qartësohet procesi i kandidimit për ata që kanë synim të jenë pjesë

e një liste zgjedhore dhe në anën tjetër iu mundëson partive politike që paraprakisht të krijojnë kuadro për përfaqësim në të dyja nivelet pa e dëmtuar përfaqësimin në njërën apo tjetrën.

Praktika e pjesëmarrjes së deputetëve në zgjedhje lokale në Kosovë është adaptuar për shkak të hapësirës që jep Ligji për zgjedhjet, i cili ua lejon deputetëve që të jenë pjesë e garës për zgjedhje lokale dhe derisa të certifikohen për mandatin për të cilin kanë garuar, ata mbajnë njëkohësisht postin tjetër si deputet. Mirëpo një mundësi e tillë ligjore, nuk do të duhej të përdorej në dëm të institucionit dhe mandatit që kanë marrë për përfaqësim të interesave të qytetarëve në legjislativ. Duke ditur ndikimin që angazhimi për një post tjetër publik ka në rolin e tij/saj si i/e zgjedhur nga populli, është e domosdoshme të vendosen disa norma etike për deputetët që kanë ambicie për funksione të tjera publike, përfshirë opsionin e dorëheqjes nga posti i deputetit që me fillimin e fushatës zgjedhore..

Partitë politike parlamentare gjegjësisht deputetët duhet të kenë parasysh faktin që janë zgjedhur për të përbushur obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave dhe ligjeve që ua përmirësojnë jetën atyre. Kuvendi duhet t'i përmbahet kalendarit të punës edhe në kohë të zgjedhjeve lokale, duke respektuar në radhë të parë Rregulloren e punës dhe kriterin për numrin e mbledhjeve dhe seancave që duhet të mbajtur. Dhe, njëkohësisht, të funksionojë me dinamikë të shtuar konform çështjeve që u shtrohen për trajtim, në mënyrë që të mos zvarriten ato çështje që kërkojnë trajtim nga deputetët dhe të mos pengohet funksionimi i mirëfilltë i Kuvendit.



